

VENDIM
Nr. 319, datë 12.12.2022

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALKAN ENERGY TRADE” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039/6 prot., datë 7.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Balkan Energy Trade’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

-Shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015 prot., datë 30.11.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksi A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

-Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a” dhe “d” dhe pikën 2.5.

- Nga ky aplikim rezultojnë mungesa në dokumentacionin si më poshtë:

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: aplikuesi nuk ka përcjellë vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj;

- germa “c”: aplikuesi nuk ka përcjellë informacion në lidhje me parashikimin për shtimin e stafit sipas planit të biznesit dhe nëse në strukturën e shoqërisë do të integrohet edhe staf teknik i cili do të kujdeset për tregtimin e energjisë elektrike, duke qenë se aktualisht stafi i deklaruar përbëhet vetëm nga administratori. Sa më sipër depozituar, struktura e shoqërisë vlerësohet e pa plotë.

- Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “a”: shoqëria nuk ka përcjellë vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore; - germa “b”: në vijim të depozitimit të bilanceve për periudhën aktive të shoqërisë, konstatohet se kjo e fundit nuk ka depozituar dokumentacion në kuadër të mbështetjes financiare, ndaj vlerësohet t’i kërkohej që të depozitojë dokumentacionin referuar vlerës së investimit bazuar në planin e biznesit;

- germa “c”: në vijim shoqëria për llogaritjen e mbështetjes financiare ku të ketë garantuar të paktën një muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi nuk i është referuar çmimit të bursës, për parashikimin vjetor të kostove. Gjithashtu në planin e biznesit nuk përcaktohet mënyra sesi kjo e fundit do të mbulojë financiarisht këtë plan.

- Në kuadër të mos plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet mosfillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në rast se shoqëria, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet në ERE dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Në rast se shoqëria brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet në ERE dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti